# DËSHMI ARKIVI

**A-394115**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Përvëlohet” Spanja: Shtatori nis ndryshe në Europë, vera nuk po largohet! |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/pervelohet-spanja-shtatori-nis-ndryshe-ne-europe-vera-nuk-po-largohet-i584113` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 5 shtator 2026, 13:22:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 5 shtator 2026, 14:05:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2a04eb93aa2ed4ce131e0acb66e7f92b2ba80c488edc6c2a1b31e199b1bb698f` |
| TEKSTI | `db18b85b079ed76f6412b02b33ee5d1dc2f7e573ea4ff07859dcd2f9821a4105` |
| PAMJA | `044a24d473e1fca95e7bca4225cdc9fb0a8e442e1e2ca77e2a75f27bb2842fcc` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `17352ae221c727b2d4762e7717237769a6c1e87c7bf30bb15947c27da8a34d56` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326` |
| ANKORUAR | Polygon PoS · bllok 46991200 |
| TRANSAKSIONI | `0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3` |
| IPFS | `QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz` |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/17352ae221c727b2d4762e7717237769a6c1e87c7bf30bb15947c27da8a34d56`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Përvëlohet” Spanja: Shtatori nis ndryshe në Europë, vera nuk po largohet!

TemA
5 Shtator 2026, 16:05Bota TEMA




Ende nuk ka vjeshtë për Spanjën, vendi regjistroi së fundmi temperaturën më të lartë të shënuar ndonjëherë gjatë muajit shtator, pasi në qytetin El Granado, në jugperëndim të vendit, termometri shënoi 45.7 gradë Celsius, të dhëna këto të konfirmuara nga Agjencia Shtetërore Meteorologjike e Spanjës (AEMET).

Temperatura e regjistruar në El Granado barazoi rekordin kombëtar për muajin shtator, prej 45.7 gradë Celsius, i vendosur në Montoro në vitin 2016. Të dyja qytetet ndodhen në rajonin jugor të Andaluzisë. Kjo ishte sakaq edhe temperatura më e lartë në Spanjë përgjatë gjithë vitit. Ajo vjen në kohën kur një tjetër valë të nxehti me temperatura që kapërcyen 40 gradët Celsius, ka përfshirë pjesë të mëdha të jugut dhe perëndimit të vendit gjatë kësaj jave.

Italia sakaq po përballet me valën e gjashtë të të nxehtit, me temperatura rreth 34–35°C në shumë qytete të veriut dhe rajoneve qendrore, të cilat janë dukshëm mbi mesataren sezonale. Dara e të nxehtit vazhdon po kështu të mundojë edhe jugun e Francës.

Vera e këtij viti po rezulton jashtëzakonisht e gjatë dhe e nxehtë. Ajo nisi herët, që në maj, dhe vazhdoi me disa valë të njëpasnjëshme përvëlimi. Këtë situatë, ekspertët e lidhin me ndikimin e vazhdueshëm të anticiklonit afrikan, i cili po sjell masa ajri shumë të nxehta.

Në Itali, meteorologët thonë se një ftohje e motit mund të pritet nga e enjtja, me mbërritjen e masave të freskëta ajrore nga Atlantiku i Veriut, por ato mund të shoqërohen me stuhi të forta dhe breshër. Megjithatë, edhe kjo mund të mos shënojë fundin e verës, pasi sipas të dhënave të Qendrës Europiane, temperaturat mbi mesataren ka gjasa të vazhdojnë deri në fillim të tetorit.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Ndalohet mishi brazilian, zv.ministrja e bujqësisë: Forcojmë kontrollet në pikat kufitare! Rrezik për shtrenjtim të mishit? Kika: Prioritet siguria ushqimore

15:15 Bota

Bllokada e naftës dhe sanksionet, ambasada amerikane lëshon alarm shëndetësor për Kubën

13:55 Bota

[A mund ta zgjidhë një kujdestar i BE-së bllokimin e gjatë mbi asetet ruse?]

12:45 Bota

[Raketa amerikane godet cisternën iraniane pranë Khargut, rriten tensionet në Gjirin Persik]

11:55 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.